

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, “Mbi miratimin e ‘Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve””, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 196, datë 20.12.2021, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Neni 7, pika 2, germa “d”, ishte: “marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën, në rastet e barrësimit, hipotekimit etj., të kuotave/aksioneve”.

Neni 7, pika 2, germa “d”, bëhet : “marrëveshje paraprake për transferimin e kuotave nëse ka”.

Neni 9, pika 2, ishte: “Në çdo rast, por jo më vonë se 5 ditë pune nga paraqitja e kërkesës ...”

Neni 9, pika 2, bëhet: “Në çdo rast, por jo më vonë se 10 ditë pune nga paraqitja e kërkesës...”